

FEDERATA E PARA BOCCIA TË KOSOVËS

Nr. Fiskal / NRB : 602772122

Numri i regjistrimit : 5119723-2

Raporti i Auditori i Pavarur dhe Raporti Financiar
Për Memorandumin e bashkëpunimit” Mbështetja për Federatat Para
sportive në
Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR..... 3

DEKLERATA E PAJTUSHMERISË 6

I. Pasqyra financiare e sponsorizimeve..... 7

II. Shënimet për “Pasqyrat Financiare” 8

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e FEDERATA E PARA BOCCIA TË KOSOVËS

Në përputhje me termat e referencës të datës 20 Gusht, ju ratë dakord me ne, që ne të ofrojmë Raportin tonë të Gjetjeve Faktike ("Raporti"), në lidhje me Raportin Financiar shoqërues për periudhën që mbulon vitin 2025. Ju keni kërkuar që të kryhen disa procedura në lidhje me Raportin tuaj Financiar për kontratën e lidhur me, **Komitetin Paralimpik të Kosovës (MKRS)** lidhur me mbështetjen financiare për Memorandumin e mbështetjes për Federatat Para sportive në kuadër të Komitetit Paralimpik të Kosovës.

Objektivi

Angazhimi ynë ishte një verifikim i shpenzimeve që është një angazhim për të kryer disa procedura të rëna dakord në lidhje me Raportin tuaj Financiar për kontratën e lidhur me **Komitetin Paralimpik të Kosovës** lidhur me mbështetjen financiare për Memorandumin e mbështetjes për Federatat Para sportive në kuadër të Komitetit Paralimpik të Kosovës.

Objektivi i këtij verifikimi të shpenzimeve është që ne të kryejmë disa procedura për të cilat kemi rënë dakord dhe t'ju paraqesim një raport të gjetjeve faktike në lidhje me procedurat e kryera.

Opinionin

Ne kemi audituar Raportin Financiar shoqërues të projektit: Memorandum bashkëpunimi me **Komitetin Paralimpik të Kosovës**. Projekti është zbatuar nga Federata e Para Boccia të Kosovës i financuar nga Ministria e Kulturës Rinis, dhe Sportit.

Sipas opinionit tonë, Raporti Financiar i memorandumit, është përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e kontratës në përputhje me ligjet përkatëse në Kosovë.

Baza për opinionin

Angazhimi ynë u krye në përputhje me:

- Standardi Ndërkombëtar për Shërbimet e Ndërlidhura ('ISRS') 4400 Angazhimet për të kryer procedurat e dakorduara në lidhje me informacionin financiar siç është shpallur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve ('IFAC');
- Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë i nxjerrë nga IFAC. Megjithëse ISRS 4400 parashikon që pavarësia nuk është një kërkesë për angazhimet e procedurave të dakorduara, Ne kemi respektuar gjithashtu kërkesat e pavarësisë të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë;
- Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Procedurat e kryera

Siç është kërkuar, ne kemi kryer vetëm procedurat për të ndihmuar Autoritetin Kontraktues në vlerësimin nëse shpenzimet e pretenduara nga ju në Raportin Financiar shoqërues janë të pranueshme në përputhje me termat dhe kushtet e Kontratës.

Për shkak se procedurat e kryera nga ne nuk përbënin as auditim apo rishikim të bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ose Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit, ne nuk shprehim asnjë siguri për Raportin Financiar shoqërues. Sikur të kishim kryer procedura shtesë ose të kishim kryer një auditim ose rishikim të pasqyrave financiare të Përfituesit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, çështje të tjera mund të kishin ardhur në vëmendjen tonë që do t'ju ishin raportuar.

Burimet e Informacionit

Raporti përcakton informacionin e dhënë nga ju në përgjigje të pyetjeve specifike ose siç është marrë dhe nxjerrë nga llogaritë dhe të dhënat tuaja.

Gjetjet faktike

Shpenzimi i përgjithshëm i cili është objekt i këtij verifikimi të shpenzimeve është 20,000.00 euro nga gjithsej 20,000.00€ sa ka qenë i paraparë.

Raporti i Mbulimit të Shpenzimeve është 100%. Ky raport përfaqëson shumën totale të shpenzimeve të verifikuara nga ne të shprehur në përqindje të totalit të shpenzimeve që i janë nënshtruar këtij verifikimi shpenzimesh. Informacione të tjera të ndryshme nga Raporti Financiar dhe Raporti i Audituesit mbi to Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera.

Opinionin ynë mbi raportin financiar nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Informacione të tjera të ndryshme nga Raporti Financiar dhe Raporti i Audituesit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinionin ynë mbi raportin financiar nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e raportit financiar, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Raportit Financiar në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të kontratës midis **Federata e Para Boccia të Kosovës** dhe **Komitetit Paralimpik të Kosovës** dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e Raportit Financiar që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Raportit Financiar

Sipas Standardit Ndërkombëtar për Shërbimet e Ndërlidhura (ISRS) 4400, përgjegjësitë tona përfshijnë kryerjen e procedurave të dakorduara me palët e interesuara në lidhje me informacionin financiar të organizatës. Këto procedura janë kryer me qëllim për të identifikuar dhe raportuar gjetjet faktike, pa dhënë një opinion ose sigurim për saktësinë e informacionit financiar. Ne kemi kryer këto procedura në përputhje me kërkesat etike të aplikueshme dhe, ku është e nevojshme, kemi respektuar kërkesat për pavarësi të parashikuara nga Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë. Raporti ynë përmban gjetjet e procedurave të kryera, të cilat janë bazuar në evidencën që konsiderojmë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për qëllimet e angazhimit tonë.

Përdorimi i këtij Raporti

Ky raport është vetëm për qëllimin e përcaktuar në objektivin e mësipërm.

Ky raport është përgatitur vetëm për përdorimin tuaj konfidencial dhe vetëm për qëllimin e paraqitjes nga ju tek Autoriteti Kontraktor në lidhje me kërkesat e përcaktuara të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës. Ky raport nuk mund të mbështetet nga ju për ndonjë qëllim tjetër dhe as nuk mund t'i shpërndahej palëve të tjera.

Autoriteti kontraktor nuk është palë në marrëveshjen (kushtet e referencës) midis jush dhe nesh dhe për këtë arsye ne nuk i detyrohemi ose marrim një detyrim ndaj Autoritetit Kontraktor, i cili mund të mbështetet në këtë raport të verifikimit të shpenzimeve me rrezikun dhe gjykimin e tij, Autoriteti Kontraktor mund të vlerësojë vetë procedurat dhe gjetjet e raportuara nga ne dhe të nxjerrë konkluzionet e veta nga gjetjet faktike të raportuara nga ne. Autoriteti kontraktor mund t'ua zbulojë këtë raport vetëm të tjerëve që kanë të drejta rregullore.

Ky Raport lidhet vetëm me Raportin Financiar të specifikuar më poshtë dhe nuk shtrihet në asnjë nga pasqyrat tuaja financiare.

Ne presim të diskutojmë Raportin tonë me ju dhe do të jemi të kënaqur të ofrojmë çdo informacion ose ndihmë të mëtejshme që mund të kërkohet.

Agron Mustafa, auditor ligjor

Nënshkrimi _____

No.Licencës:28

15 Janar 2026



Emri i organizatës	FEDERATA E PARA BOCCIA TË KOSOVËS
Lloji organizatës	OJQ
Numri I regjistrimit	5119723-2
NRF:	602772122
Adresa:	Kemail Ataturk, Mitrovicë

DEKLERATA E PAJTUSHMERISË

Bazuar në njohurit tona më të mira, deklarojmë se Raporti Financiar është përgatitur në përputhje me kërkesat e donatorit për raportim financiar dhe në përputhje me ligjet përkatëse në Kosovë.

10 janar 2026



Murat Murati

President

Federata e Paraboccia të Kosovës



I. PASQYRA FINANCIARE E SPONZORIZIMEVE

Përshkrimi	Shënim	Shuma e disponueshme për shpenzime (€)	Vlera e realizuar në shpenzime (€)
a		b	c
Burimet:			
Të hyrat MKRS përmes KPK		20,000.00	20,000.00
Shpenzimet:			
1.Pagat		8200.22	8200.22
2. Pajisje dhe rekuizita sportive		1500.00	1500.00
3. Qeraja e zyres		1547.00	1547.00
4. Shpenzime per materiale dhe promovim te aktiviteve direkte		2465.00	2465.00
5.Shperblimet/cmimet per fituesit		900.00	900.00
6.Meditje per personat profesional ne aktivite		1430.00	1430.00
7.Ushqim dhe pije		1930.00	1930.00
8. Shpenzime te derivateve		1059.00	1059.00
9.Pagesa e anetaresise ne BISFED		518.78	518.78
10.Shpenzime operative		450.00	450.00
Totali i shpenzimeve		20,000.00	20,000.00
Bilanci i fondeve		0.00	0.00

Raporti Financiar është aprovuar për publikim më 10 tetor 2024 dhe nënshkruar nga:



Murat Murati

Kryetar

FEDERATA E PARA BOCCIA TË KOSOVËS



Shënimet shoqëruese nga 8 deri 10 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

II. SHËNIMET PËR "PASQYRAT FINANCIARE"

1. Informata të përgjithshme

Emri i organizatës	FEDERATA E PARA BOCCIA TË KOSOVËS
Lloji i organizatës	OJQ
Numri i regjistrimit	5119723-2
Numri fiskal	602772122
Adresa:	Lipjan, Rr. Skenderbeu
Mob:	049570684; 044811833
E-mail:	kosovobocciafederation@gmail.com sekretari.fpbok@gmail.com

Federata e Para Boccia të Kosovës (më tutje FPBK) është asociacion i pavarur sportiv i cili bashkon të gjitha klubet dhe asociacionet sportive të personave me aftësi të kufizuara në fushën e sportit Para Boccia.

Themeluesit e Organizatës janë:

- Sinan Hoti - (Klubi Para Boccia Për Persona me Aftësi të Kufizuara "New Image 08" Xërxë), Fitim Halili - (Klubi Para Boccia për Persona me Aftësi të Kufizuara "Maja e Pashtrikut" Gjakovë), Shpresa Rafuna - (Klubi i Para Boccia Për Persona me Aftësi të Kufizuara "Minatori" Mitrovicë), Fahrije Llugiqi - (Klubi i Para Boccia Për Persona me Aftësi të Kufizuara "Blinaja" Lipjan), Kenan Zylfiçari - (Klubi i Para Boccia Për Persona me Aftësi të Kufizuara "Hendifer" Ferizaj).

Qëllimet e FPBK Organizimi, avancimi, masovizmi dhe zhvillimi cilësor i Para Boccia duke përfshirë sa më shumë Persona me aftësi të kufizuara (PAK), organizimi e garave kampionale dhe garave të tjera sportive. Ngritja e cilësisë së sportit të Para Boccistëve në shkallë kombëtare dhe afirmimit ndërkombëtar. Përfaqësimi i FPBOK në Institucionet Ndërkombëtare.

2. Informacion i përgjithshëm i projektit

Emri i Projektit	Memorandum Bashkpunimi me Komitetin Paralimpik të Kosovës për mbështetje të Federatave Parasportive
Projekti	Mbështetja e Federates Boccia
Dhënesi i mjeteve	Komiteti Paralimpik i Kosovës MKRS
Emri i marrësit	Federata e Para Boccia të Kosovës
Data e nënshkrimit	20.08.2025
Shuma e mbështetjes	20,000.00

Memorandumi	PN datë: 20.08.2025
Qëllimi i Projektit	Qëllimi i projektit është mbështetje financiare për aktivitetet e FPBK-së të cilat realizohen në fushën e sportit për persona me aftësi të kufizuara.

3. Baza e përgatitjes dhe përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël

3.1. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat financiare të projektit janë përgatitur për qëllime të raportimit në Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), mbi aktivitetet e Projektit në lidhje me financimin e marrë për përmbushjen e objektivave të Projektit në përputhje me Marrëveshjen përkatëse të Bashkëpunimit. Pasqyra financiare e projektit përfshin të gjitha shpenzimet e realizuara në lidhje me projektin, të cilat financohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).

Pasqyrat financiare të projektit janë përgatitur mbi bazën e pranimit dhe pagesës në para në përputhje me dispozitën përkatëse të përcaktuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Një nga këto të ardhura njihen kur janë marrë jo kur kanë fituar dhe shpenzimet njihen kur janë paguar dhe jo kur kanë ndodhur.

Të gjitha të dhënat janë paraqitur në EURO.

3.2. Monedhe e huaj

Pasqyra Financiare e Projektit është e shprehur në monedhën evropiane (EUR) në përputhje me kërkesat e donatorit.

4. Burimet e fondeve

Burimi i Fondeve	Vlera	Vlera e pranuar	Diferenca	%	Vlera e realizuar %
Burimi MKRS	20,000.00	20,000.00	0	0%	100%
Total	20,000.00	20,000.00	0	0%	100%

5. Shpenzimet operative

Përshkrimi	Shënim	Shuma e disponueshme për shpenzime (€)	Vlera e realizuar në shpenzime (€)
a		b	c
Burimet:			
Të hyrat MKRS përmes KPK		20,000.00	20,000.00
Shpenzimet:			
1. Pagat		8200.22	8200.22
2. Pajisje dhe rekuizita sportive		1500.00	1500.00
3. Qeraja e zyres		1547.00	1547.00
4. Shpenzime për materiale dhe promovim të aktiviteteve direkte		2465.00	2465.00
5. Shperblimet/cmimet për fituesit		900.00	900.00

6.Meditje per personat professional ne aktivite		1430.00	1430.00
7.Ushqim dhe pije		1930.00	1930.00
8. Shpenzime te derivateve		1059.00	1059.00
9.Pagesa e anetaresise ne BISFED		518.78	518.78
10.Shpenzime operative		450.00	450.00
Totali i shpenzimeve		20,000.00	20,000.00
Bilanci i fondeve		0.00	0.00

6. NGJARJET PASUESE

Nuk ka ngjarje tjera pas datës së raportimit që do të kërkonin shpalosje në pasqyrat financiare të organizatës.